



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 303 Prot.

Tiranë, më 19.02.2019

**VENDIM**

**Nr.10, datë 19.02.2019**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 93, DATË 22.11.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 93, datë 22.11.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së nëpunësit \*\*\*\*\*”, protokolluar me nr. 714 prot., datë 14.09.2018”, në institucionin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 714 prot., datë 14.05.2018, nëpunësi \*\*\*\*\* ka ngritur pretendimet se, gjatë realizimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2018, janë kryer dhe lejuar veprime të cilat vijnë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar.

Pas hetimit administrativ të këtij rasti, Komisioneri ka përmyllur procesin me Vendimin Nr. 93, datë 22.11.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së nëpunësit \*\*\*\*\*”, protokolluar me nr. 714 prot., datë

14.09.2018”, në të cilin Komisioneri në pjesën urdhëruese ka kërkuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural të drejtojë procesin me qëllim rikthimin e ligjshmërisë duke ndërmerrë këto veprime:

- anulimin e aktit të vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin \*\*\*\*\*,  
(*periudha Janar - Qershor 2018*);
- përsëritjen e procesit dhe përmbylljen e tij brenda afatit të lënë në vendimin paralajmërues të Komisionerit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji;
- aktet administrative si dhe shënimet përkatëse që shoqërojnë këtë proces, duhet t’i njoftohen nëpunësit të interesuar dhe të bëhen pjesë e dosjes së personelit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 93, datë 22.11.2018, institucioni me shkresën nr. 4394/6 prot., datë 13.12.2018, “*Kthim përgjigje Vendimit nr. 93, datë 22.11.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*”, ka informuar Komisionerin për masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.

Nga analiza e dokumentacionit bashkëlidhur kësaj shkrese, rezulton se:

- Titullari i institucionit me Urdhrin nr. 482, datë 12.12.2018, “*Për revokimin/anulimin e aktit të formularit të vlerësimit të punës*” ka anuluar aktin e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin \*\*\*\*\* , për periudhën Janar - Qershor 2018.
- Me shkresën nr. 6292/1 prot., datë 12.12.2018, “*Njoftim*”, nëpunësi është njoftuar për përsëritjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën 01.01.2018 - 30.06.2018.

Sipas dokumentacionit që materializon zhvillimin e këtij procesi, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse janë korigjuar të gjitha mangësitë e evidentuara nga Komisioneri në procesin e mëparshëm të vlerësimit të rezultateve në punë (*Lidhja 2, formular i vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesëm drejtues*). Akti i ri i vlerësimit në përputhje me rekomandimin e lënë në arsyetimin e këtij vendimi është kryer drejtpërdrejt nga titullari i institucionit dhe është plotësuar me komente në rubrikat përkatëse duke identifikuar aftësitë dhe dobësitë e nëpunësit civil.

Në zbatim të pikës 2 të vendimit objekt verifikimi, me shkresën nr. 4394/6 prot., datë 13.12.2018, institucioni ka informuar se aktet administrative si dhe shënimet përkatëse që

shoqërojnë këtë proces, i janë njoftuar nëpunësit të interesuar dhe janë bërë pjesë e dosjes së personelit të nëpunësit civil.

Në përfundim të këtij procesi dhe në zbatim të detyrave të lëna në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe Vendimin paralajmërues, Nr. 82, datë 4.10.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njësia përgjegjëse ka përfshirë në Regjistrin Qëndror të personelit rezultatin e vlerësimit të punës për periudhën Janar-Qershor 2018, të nëpunësit \*\*\*\*\*.

Për sa u parashtrua më sipër, rezulton se nga ana e institucionit, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 93, datë 22.11.2018, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së nëpunësit \*\*\*\*\*; protokolluar me nr. 714 prot., datë 14.09.2018”*.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 93, datë 22.11.2018, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së nëpunësit \*\*\*\*\*; protokolluar me nr. 714 prot., datë 14.09.2018”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 93, datë 22.11.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe ankuesi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**